



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

**NJOFTIM PARAPRAK
PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT**

**RISHIKIM I STUDIMIT TË FIZIBILITETIT DHE HARTIMI I PROJEKTIT TË
DETAJUAR INXHINIERIK "NDËRTIMI I TUNELIT TË LLOGARASË"**

Autoriteti kontraktor, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në mbështetje të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik“ të ndryshuar, si edhe bazuar në parimin e transparencës dhe nxitjen e konkurrencës, njofton paraprakisht operatorët ekonomikë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të interesuar mbi planifikimin për zhvillimin e procedurës si më poshtë vijon:

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Adresa	Rruga “Abdi Toptani” nr. 1 Tiranë
Person Përgjegjës	Jonaid Myzyri
E-mail	jonaid.myzyri@infrastruktura.gov.al
Faqja në Internet	www.infrastruktura.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Shërbim Konsulence.

3. Objekti i kontratës: “Rishikim i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik "Ndërtimi i Tunelit të Llogarasë".

4. Përshkrimi i Kontratës: Kontraktori duhet të kryej shërbimin për hartimin e projektit të detajuar të zbatimit për ndërtimin e tunelit të Llogarasë, hartimin e preventivave përfundimtare, e cila do të shoqërohet me rishikimin e Studimit të Fizibilitetit, hartimin e projekt idesë përfundimtare, si dhe hartimin e Vlerësimit Paraprak të Ndikimit Mjedisor (VPNM).

5. Fondi limit i parashikuar: 625,000,000 lekë pa përfshirë Vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

6. Burimi i Financimit: Buxheti i Shtetit.

7. Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj.

8. Koha e Planifikuar për shpalljen e procedurës: Qershor 2020.

9. Informacion shtesë :

Bazuar në Vendimin. Nr. 943, datë 28.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, subjektet fizike / juridikë të huaj duhet të aplikojnë në portalin e-albania për tu pajisur me ekuivalentim të licencës.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton se vetëm për aplikantët (shoqëri të huaja/ individ të huaj) të interesuar për marrjen pjesë në procedurën e mësipërme të prokurimit do të aplikohet procedurë e përshpejtuar për 5 ditë.

Për më shumë informacion në lidhje me procedurën e përshpejtuar lutem klikoni në linkun

<https://www.infrastruktura.gov.al/shprehje-interesi/>

<https://www.infrastruktura.gov.al/en/shprehje-interesi/>